

Nr.regj. 16966/2010

OPK

03/2403/13

15.08.13

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË, DEPERTAMENITI I PERGJITHSHËM, Divizioni i Kundërvajtës, në procedurën kundërvajtës kundër të pandehurit Astrit Salihu nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 6 par 1 dhe 2 e sanksionuar sipas nenit 16 paragrafi 1.2 i ligji për deklarimin, prejardhjen e kontrollit e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publik dhe Ligj nr. 3/L – 151 e në bazë të nenit 73,74,27,28 nenit 27 .al. 4 dhe nenit 198 al. 1 pika 7 të LMK-së me dt. 18.06.2013 merre këtë:

## AKTVENDIM

**PEZULLOHET** procedura kundërvajtës ndaj të pandehurit Astrit Salihu nga Prishtina Procedura pezullohet konform nenit 198 al. 1 pika 7, lidhur me nenin 27 aline 4 të LMK, pasi që ka arritur parashkrimi **Absolut** i ndenjës së kundërvajtjes.

Nga një kopje e këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe parashtuesit të kërkesës.

## Arsyetim

**Agjensioni Kunder Korruposion** parashtroi kërkesën nr. 01/2295/10 te dt. 08.06.2010 për inicimin e procedurës kundërvajtës ndaj të pandehurit të lartpërmendur, si dhe për kundërvajtje e cekur ma lartë.

Në bazë të kërkesës së parashtuar Gjyqtari merr aktvendimin mbi denimin më dt. 29.11.2011 Aktvendimi mbi dënimin disa herë është tentuar që ti dorëzohet të pandehurit-ve por edhe pas ndërmarrjes të gjitha veprimeve të mundshme, aktvendimi nuk ka mundur ti dorëzohet me kohë dhe të behet i plotfuqishëm

Duke patur parasysh, atë se kunderërvajtja është kryer me dt. 31.03.2010 dhe se nga data e kryerjes kanë kaluar ma shume se dy vite, Gjyqtari konform nenit 27 al. 4 të LMK-ës, konstatoi se që ka ardhur deri te parashkrimi apsolut andaj, nuk ka bazë ligjore për zhvillimin e mëtejshëm të procedurës kundërvajtëse, ndaj të pandehurit, për çka konform nenit 198 al. 1 pika 7 të LMK-së PEZULLOI procedurën kundërvajtës.

Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

VENDOSI GJYKATA THEMELORE PRISHTINË, DEPERTAMENITI I PERGJITHSHËM,  
Divizioni i Kundërvajtës

GJYQTARI

Fatmir Behrami

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët ankesë mund ti ushtrohet Gjykatës së Apelit Divizioni i Kundërvajtjes në Prishtinë,në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjes së këtij aktvendimi nëpërmjet të kësaj Gjykate dhe pa taksë.